



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 568/5 Prot.

Tiranë, më 07. 11. 2016

V E N D I M

Nr. 114, datë 07. 11. 2016

***Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 568/1 prot, datë 12.10.2016***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Bordit Rajonal të Kullimit Fier, për rastin e pretendimeve të ngritura nga ankuesja *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 568/1 prot, datë 12.10.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i informacionit të përcjellë nëpërmjet kërkesës, paraqitur nga ankuesja ***** , në lidhje me procedurën e ndërprerjes së marrëdhënieve të saj të punës, pranë Bordit Rajonal të Kullimit Fier.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 568/2, datë 12.10.2016, "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", është vënë në dijeni Bordi Rajonal i Kullimit Fier për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Institucioni i Bordit Rajonal të Kullimit Fier, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr.782/1, datë 18.10.2016, (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 568/4 prot., datë 21.10.2016), ka parashtruar se punonjësja ***** , aktualisht nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi nuk është subjekt i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Pas verifikimit të këtij pretendimi, rezulton se kjo punonjëse, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ka përfutur statusin e punësimit si nëpunëse civile, në bazë të nenit 67, pika 3, e këtij ligji dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e

nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, prandaj, me të drejtë, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 3315/11 prot., dt. 31.10.2014, e ka deklaruar nëpunës civil.

Nga hetimi i mëtejshëm administrativ, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë të veprimeve të kryera, në lidhje me procedurën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të punonjësve ***** , ka rezultuar se, pas ndryshimeve që iu bënë ligjit për nëpunësin civil në nenin 2, pika "k", të tij, parashikohet shprehimisht se, *"Punonjësit e bordeve të kullimit, përjashtohen nga fusha e veprimit të këtij ligji"*.

Në këto kushte, pozicioni i punës *"Specialist"*, në Bordin Rajonal të Kullimit Fier, nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil dhe për këtë arsye marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, rregullohen nëpërmjet dispozitave të Kodit të Punës.

Në këto rrethana, arrihet në konkluzionin se, përdorimi prej drejtuesit të Bordit Rajonal të Kullimit Fier, të dispozitave të Kodit të Punës, dhe jo të atyre të shërbimit civil, për vënien në diskutim të vazhdimësisë së marrëdhënies së punës të punonjësve ***** , vlerësohen të mbështetura në ligj. Në këto kushte, në bazë të nenit 34, të Rregullores *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vend për përfundimin e procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34, të Rregullores *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin nr. 568/1 prot, datë 12.10.2016, *"Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësja ***** , në lidhje me procedurën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, në Bordin Rajonal të Kullimit, Fier"*.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Bordi Rajonal i Kullimit Fier dhe kërkuesja ***** . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA